

**Etje Për Fillim Të Ri!** (pjesa 2 nga 5)  
Dua Të Gjej Rrugën e Kthimit Te Perëndia.

Përshëndetje, a po e shijoni festimin sot? Jemi në pjesën e dytë të serisë: “Dua Të Gjej Rrugën e Kthimit Te Perëndia.” E sigurt që gjatë kësaj kohe kemi parë shumë persona që kanë gjetur rrugën e kthimit te Perëndia.

Por kjo seri nuk është vetëm për momentin kur zgjedh për të ndjekur Jezusin për herë të parë, sepse e dimë që ecja jonë me Zotin është udhëtim i përditshëm. Është marrëdhënie që ka uljet dhe ngritjet e veta...

-Disa herë ne e gjejmë veten larg shtëpisë.

-Disa herë ne i kthejmë shpinën Perëndisë dhe njerëzve rreth nesh me shpresën se do të gjejmë diçka më shumë atje ku do të shkojmë.

-Disa herë tentojmë se kemi dëshirën për të provuar gjëra të reja para se të vendosim edhe pse shumë prej atyre gjërave ua dimë fundin.

Të gjesh rrugën e kthimit te Perëndia është moment jetëndryshues por gjithashtu është edhe proces rritjeje dhe forcimi i karakterit tonë, në ngjasim me atë të Perëndisë.

Në këtë seri jemi të fokusuar te 5 Etje që ka çdo person. Javën e shkuar folëm për etjen e parë, "Etje Për Më Shumë".

Kjo lloj etje na krijon atë ndjesinë tensionuese që *duhet të ketë më shumë se kaq, më shumë nga sa kam arritur deri tani; jeta duhet të ketë më shumë se kaq.*

Pamë se kjo etje përmbledh atë etjen për t'u dashur nga dikush dhe për të dashur dikë; etjen për qëllim të qartë në jetë, etjen për kuptim, shpjegim të gjërave të vështira të jetës.

Fatkeqësisht ne shkojmë për t'i plotësuar, për t'i shuar diku tjetër, larg Perëndisë këto etje që Ai i ka vendosur brenda nesh.

Fillojmë të ndjekim gjëra që mendojmë se do të na sjellin plotësim. Fillojmë lidhje të reja, jepemi më shumë pas punës, pas parasë, pas argëtimit. Disa herë kjo rendje pas këtyre gjërave na çon në vendime dhe në vende që nuk e kishim menduar se do të shkonim ose do të përfundonim aty.

Më pas arrijmë të kuptojmë se jeta nuk po sjell atë që prisje, atë që shpresoje, s'po sjell asgjë fare. Shpesh e gjejmë veten duke menduar ose duke thënë: *“Sikur ta kisha mundësinë t'ia filloja edhe një herë nga fillimi.”*

A të ka ndodhur edhe ty? A ke arritur në atë pikë një ose disa herë në jetë, që uroje ta kishe mundësinë t'ia filloje edhe një herë nga e para? A s'do të ishte bukur sikur të na jepej mundësia t'ia fillonim edhe një herë nga e para?

Sikur të ktheheshe pas në kohë, tek ai momenti kur e more atë vendim kot, sikur të ktheheshe aty dhe ta rifilloje nga e para? Mua për vete më ka ndodhur kjo situatë. Ka shumë gjasa që të ka ndodhur edhe ty. Ka shumë gjasa që disa prej jush jeni sonte në

një pikë të tillë.

Pjesë e festimeve javore kemi dëshmi të bukura se si ju e keni gjetur rrugën e kthimit te Perëndia. (jepen dëshmi nga persona nga kisha, se si ata e gjetën rrugën e kthimit te Perëndia)

### **Luka 15:11-24 (Bibla)**

**11.** Një njeri kishte dy bij. **12.** Më i riu i tyre i tha babait: "Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon". Dhe i ati ua ndau mes tyre pasurinë. **13.** Mbas pak ditësh biri më i ri mblodhi çdo gjë, shkoi në një vend të largët dhe atje e prishi gjithë pasurinë, duke bërë një jetë të shthurur.

**14.** Por, si i shpenzoi të gjitha, në atë vend ra një zi e madhe buke, dhe ai filloi të jetë në hall.

Le të fokusohemi sot te kjo pjesë e historisë së këtij djali:

**17.** *Atëherë erdhi në vete dhe tha: "Sa punëtorëve mëditës të atit tim u tepron buka, kurse unë po vdes nga uria!*

**18.** *Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë dhe do t'i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje.*

Sot dua të fokusohemi te dy fragmente të kësaj historie...

Së pari, **Atëherë erdhi në vete.**

Së dyti, **Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë.**

Kur ky djalosh erdhi në vete, ai po përjetonte etjen e dytë. Thashë në fillim që nga kjo histori do të shikojmë 5 Etje që pati ky djalosh dhe që ka çdo njeri.

Etja e parë ishte Etje Për Më Shumë, pra të duash diçka që s'e ke përjetuar më parë! Jeta duhet të ketë më shumë se të zgjohesh, të shkosh në punë apo shkollë, të hash bukë, të bësh ca angari, të rrish ca para TV ose internetit, të flesh gjumë se do të ngrihesh nesër prapë për punë ose shkollë. Duhet të ketë një qëllim kjo jetë, duhet të kenë një kuptim të qartë gjërat.

Djaloshi pra, u nis në një vend të largët dhe provoi të gjente diçka më shumë por në vend që të gjente diçka më shumë, humbi edhe ato që kishte marrë nga i ati. Ai është trokë tani, pa kokërr leku, nuk ka lek për të ngrënë, as për bukë me qofte, as për byrek me gjizë. Në këtë gjendje, ai vjen në një pikë të jetës që dëshironte fort të kishte: Etje të madhe për Fillim të Ri.

Këtu merr kthesën historia apo jo? *Atëherë erdhi në vete...* Nuk ka rëndësi sa gjatë kishte jetuar jetën e shfrenuar, më në fund erdhi në vete. Ngjan me atë që tha dikush këtë javë, atë që tha dikush tjetër javën e shkuar, një kohë larg Perëndisë, vjen ky momenti.

Po ty, a të ka ndodhur një gjë e tillë, në një fazë të jetës? Ti doje të provoje gjëra të reja dhe kush nuk të ka folur: *“Ej, thirri mendjes! Ajo rrugë s'të çon në ndonjë drejtim të mirë!”*. Ta kanë thënë shokët, anëtarë të familjes, gruaja/burri, kolegët e punës, megjithëse dukeshin bindëse faktet që thonin ata, prapë nuk doje të ndryshoje. Vazhdove të njëjtin stil jete derisa hase fundin dhe... *Aty të doli gjumi, i thirre mendjes. Erdhe në vete.*

Sepse të dukej që është normale ajo që po bëje. Në atë pikë të jetës, të duket sikur të tjerët e kanë gabim, sikur po të bezdisin dhe jo që ta kishin për të mirë.

Derisa një ditë... vjen në vete dhe shikon se çfarë rrëmuje të madhe ke bërë për shkak të vendimeve koti që ke marrë. Ndjen keqardhje dhe brenda vetes ke një dëshirë të thellë, etje të madhe: *"Sikur t'ia filloja edhe një herë nga fillimi"*.

Kjo është pjesë e rëndësishme në këtë histori, sepse askush nuk mund ta gjejë rrugën e kthimit te Perëndia nëse nuk *vjen në vete*, nëse nuk zgjohet.

Të zgjohesh dhe të kuptosh se vendimet e tua të kanë çuar në vende që ti nuk e imagjinoje kurrë se do të përfundoje.

*"Njeriu nuk mund të shërohet nga një ves nëse nuk e kupton vetë i pari, nëse ndërjegja e tij nuk e bind që e ka gabim, nëse zëri i Frymës nuk e bind."*

Ju të gjithë i dini këto gjëra që po ju them. Nuk po them ndonjë gjë të re. Por ajo që mund të ndodhë sonte, ndërkohë që po dëgjon, mund të jetë moment zgjimi, mund të jetë momenti kur ti vjen në vete dhe e kupton që jeta jote është nisur në një drejtim që i dihet fundi dhe ai fund nuk është i mirë për ty. Lutem që sot ta kuptosh se:

Tani Është Koha Për T'u Kthyer Në Shtëpi ...

Pjesa tjetër është se djali erdhi në vete dhe vendosi që do të kthehej në shtëpi tek i ati. Vendosi për t'u kthyer në shtëpi.

Ose e thënë ndryshe, ajo që djali bëri, kur u kthye mbrapa tek i ati, quhet *“pendesë”*. A e ke dëgjuar më parë këtë fjalë?

Fjala ‘pendesë’ në gjuhën origjinale Greke është: "Metanoia". Kjo fjalë haset shumë shpesh në Dhjatën e Re dhe do të thotë: *“Të Ndysosh Mendim”*.

Fjala ‘pendesë’ në gjuhën Hebraike është: "Teshuva" që do të thotë: *“Të Kthehesh.”*

Pra, fjala pendesë do të thotë që mendosh ndryshe dhe të kthehesh atje nga ke ardhur. Kur Jezusi po e tregonte historinë, Ai tha se djali më në fund erdhi në vete, po mendonte ndryshe dhe vendosi të kthehej nga kishte ardhur, të kthehej tek Ati i tij. Siç edhe po e përsërisim këto javë; Vendosi të gjente Rrugën e Kthimit te Perëndia, të kthehej tek Ati, te Perëndia.

Pra, këto janë dy shprehjet ku do të fokusohemi sot:  
Luka 15:17-18.

Së pari, **Atëherë erdhi në vete.**

Së dyti, **Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë.**

Unë them që të gjithë e kemi kaluar pjesën e parë, kemi ardhur në vete, jemi zgjuar. E kemi kuptuar se vendimet që kemi marrë na kanë çuar në ca vende dhe tani ndjejmë keqardhje. Ndoshta ishin vendime financiare, ndoshta ishin vendime me një lidhje, vendime me disa gjëra dhe tani ndjen keqardhje dhe po ndodh herë pas here. Ti e kupton pjesën e parë.

Por ka persona që nuk kanë marrë hapin e dytë. Ata nuk janë kthyer në shtëpi sepse brenda vetes, ne duam të ndryshojmë, duam t'ia fillojmë nga fillimi, duam të restaurojmë atë që është prishur. Por s'na le turpi, s'na le faji, s'na le sedra, nuk na lenë frikërat që ndjejmë.

\*Nëse merret vesh, a do të më pranojnë kështu siç jam?

\*A do të jetë e njejtë miqësia ime me të tjerët kur ta marrin vesh?

\*A mund të falë Perëndia një njeri si unë, me gjithë ato të zeza që kam bërë?

Ka mundësi që këto janë disa pyetje që vijnë vërdallë në mendjen tënde dhe në vend që të kthehemi në shtëpi, ne ri-kthehemi te ky cikël pa fund i keqardhjes: *“Jam i Etur për ta filluar nga fillimi, dua të jem i falur, dua të jem i pastruar, por s'ma ma mban të hap zembrën me dikë, s'ma mban të hap zembrën as me Perëndinë dhe ngec në ciklin e keqardhjes”*. Ka njerëz që ngecin në këtë cikël muaj të tërë, disa herë edhe vite me radhë.

E di çfarë? E gjithë kjo mund të ndryshojë sot. Lutja jonë është që ti do ta gjesh rrugën e kthimit të Perëndia. Ti e di si përfundoi historia e djalit, do të themi më shumë detaje javës tjetër për këtë, por dije që unë dhe ti kemi një Atë të dashur që mezi po pret që ne të kthehemi në shtëpi.

Për shumë njerëz, momenti kur ndahet shapi nga sheqeri është kur vendosin për t'u pagëzuar. Kur vendos publikisht: *“Unë po kthehem në shtëpi.”*

Për ata që duan të pagëzohen, dua t'ju ftoj në një bisedë për pagëzimin; çfarë është pagëzimi, pse bëhet, a duhet të them gjë, si të vishem atë ditë....

Po mirë, çfarë do të thotë kjo që ti po pagëzohesh?

\* Kjo s'do të thotë që pas pagëzimit, s'do të bësh më asnjë gabim.

\* Nuk do të thotë që pas pagëzimit ti bëhesh i përsosur.

\* Por do të thotë që ti po kthehesh në shtëpi, po kthehesh aty ku e ke vendin. Pagëzimi tregon që ke vendosur, e ke marrë vendimin për t'u kthyer në shtëpi, që e ke gjetur rrugën e kthimit te Perëndia.

Javën e shkuar ju thashë për bastin që vuri Paskali (matematicieni i njohur) dhe ishte i njëjti bast që ju nxita të gjithëve për të vënë këto ditë. Bast që Perëndia është i vërtetë dhe që Ai të do ty.

Sot unë dua t'ju nxis, në fakt të gjithëve dua t'ju nxis që të bëni këtë lutje: *“Perëndi, nëse Ti je i vërtetë, unë dua të të gjej, m'u shfaq Ti mua. Më bëj të kuptoj qartë që me Ty, unë mund t'ia filloj nga fillimi.”*

Dua t'ju nxis ta thoni këtë lutje tani brenda jush, në qetësinë tuaj. *“Perëndi, nëse Ti je i vërtetë, unë dua që të të gjej, m'u shfaq Ti*



*mua. Më bëj të kuptoj qartë që me Ty, unë mund t'ia filloj nga fillimi.”* Le ta themi me zë të ulët të gjithë bashkë një zëri...

Ti nuk ke pse jeton në ciklin e keqardhjes përditë, në ciklin e Etjes për të marrë falje dhe dëshirës për të patur një mundësi të dytë, Etjes për një fillim të ri.

Historia e Djalit Plangprishës, e djalit të humbur, në një farë mënyre ngjan me historinë tënde, me historinë e jetës sime, me historitë e jetëve tona. Ati i dha atij fillim të ri dhe na jep secilit prej nesh një fillim të ri gjithashtu.

**Lutemi bashkë!**